

PROCESVERBAL- Tipi i kontratës - Shërbime

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE  
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

*(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)*

OBJEKTI I PROCEDURËS:

STUDIME, ANALIZA, MASTERPLANE (PRODUKT): “MBËSHTETJE PËR REGJISTRIMIN E PASURIVE TË PALUAJTSHME NË ZONA RURALE ME POTENCIAL ZHVILLIMI.

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): 98300000-6, -  
32353100-3 71621000-7

VLERA E FONDIT LIMIT: 81,604,940 lekë pa TVSH. Sipas kursit zyrtar të BSH vlera në euro është:  
811,585.67 Euro.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor FSHZH ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

- a. Sigurim oferte, sipas Shtojcës ...;*
- b. Formulari përmbledhës i vetdeklarimit, sipas shtojcës...*

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

Kjo pikë përmbushet sipas pikës 1/a të Kriteve të Përgjithshme (*Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8*)

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 41, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik."

## 2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet e fundit financiare 2021, 2022, 2023, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jo më pak se dyfishin e vlerës së parashikuar të fondit që prokurohet.

*Për operatorët e huaj, në rastet kur në vendin e origjinës nuk lëshohen dokumentet e kërkuara për të vërtetuar bilancet/pasqyrat financiare apo xhiron vjetore, mund të paraqesin një deklaratë për konfirmin e tyre.*

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Kjo vlerë për xhiron vjetore është kërkuar pasi vlera e parashikuar e kontratës, është mbi kufirin e lartë monetar.

---

*Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e xhiros që mund të kërkohej, autoritetet/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të xhiros brenda këtij marzhi.*

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare".

AK në miratimin e këtij kriteri ka mbajtur në vëmendje nenin 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat tatimore": "Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhënë tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji."

2.2.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare 2021, 2022, 2023, të shoqëruara me Akt Ekspertizen e Ekspertit Kontabel te Autorizuar, në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve nëneni 41, pika "c", të Ligjit nr. 10091, datë 5.03.2009 "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar", I ndryshuar, ku bilancet e dy viteve nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare". Referuar në nenin 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat tatimore: "Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhënë tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Ndërsa shoqërimi me Akt Ekspertizen e Ekspertit Kontabel te Autorizuar, është bërë duke iu referuar parashikimit në nenin 41 shkronja "c" të Ligjit nr. 1009/2009: "Personat juridikë që detyrohen për auditimin ligjor të pasqyrave financiare detyrohen të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikimit të tyre, nga ekspertë kontabël ose shoqëri audituese: "c) shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar, të cilat zbatojnë për raportimin financiar standardet kombëtare të kontabilitetit, kur, në mbyllje të periudhës kontabël, për dy vite radhazi, tejkalojnë dy prej tre treguesve të mëposhtëm: i) totali i aktiveve të bilancit, në mbyllje të periudhës kontabël përkatëse, arrin ose e kalon shumën prej 50 milionë lekësh; ii) shuma e të ardhurave nga veprimtaria ekonomike (qarkullimi) në atë periudhë kontabël arrin ose e kalon shumën prej 100 milionë lekësh; iii) ka, mesatarisht, 30 të punësuar gjatë periudhës kontabël".

### 2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1 OE duhet të paraqesë dëshmi si përvojë e mëparshme për shërbimet e ngjashme me fushat përkatëse të ekspertizës, pjesë e objektit të prokurimit, të kryera gjatë tri viteve të fundit. Vlera e kërkuar për shërbimet e mëparshme nuk duhet të jetë më e vogël se 40 % të vlerës së fondit të fondit limit të realizuar gjatë tri viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

- a) Në rastin e përvojes së mëparshme të realizuar me ent publik, si dëshmi duhet vërtetim të lëshuar nga enti publik për përmbushjen me sukses të kontratës ku të shënohen vlera, afati

i përfundimit të kontraës dhe faturë tatimore të plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi ku shënohet data, shuma dhe shërbimet e realizuara.

- b) Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen, faturat tatimore sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

*Argumentimi:* Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 3 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 40 % të vlerës së fondit limit që do të thotë që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Pasi vlera e parashikuar e kontratës, është mbi kufirin e larte monetar. Vlera për shërbime të ngjashme përbën një nivel të mjaftueshëm përvojë duke patur parashysh objektin, vlerën e kontratës dhe kohezigjatjen.

---

*Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e kontratave të ngjashme që mund të kërkohet, autoritete/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të kontratave të ngjashme brenda këtij marzhi.*

Përvoja e mëparshme është element shumë i nevojshëm që garantojnë autoritetin, se operatorët ekonomikë mbi bazën e vlerës së punëve të ngjashme zotërojnë kapacitete për të zbatuar kontratën me sukses sipas një standarti të përshtatshëm cilësie. Në mbështetje të nenit 88 pika 1 e VKM 285/2021, parashikon se “Oferta mund të paraqitet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, sipas përcaktimit të pikave 2 dhe 3, të nenit 14, të LPP-së, ku njëri prej të cilëve i përfaqëson të tjerët gjatë procedurës dhe, në rast për zgjedhjeje, edhe gjatë zbatimit të kontratës. Në ofertë duhet të përcaktohet pjesa e shërbimit, punës ose furnizimit, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi nëpërmjet një kontrate bashkëpunimi të hartuar ndërmjet palëve.

2.3.2 Licenca profesionale të operatorit për realizimin e objektit të kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore:

- a) Operatori duhet të jetë i licencuar dhe të zotërojë një licencë aktive në Projektim në Kat. 8a – Rilevime Inxhinierike, Kat. 8b – Rilevime Inxhinierike Kadastrale dhe Kat. 8c – Sisteme GIS dhe 8d – Bazamente Gjeodezike.

- Kjo do të vertetohet nëpërmjet paraqitjes së Licenses

Operatorët e huaj duhet të bëjnë ekuivalentimin e licensave profesionale që disponojnë të lëshuara nga vendi i origjinës, pranë Ministrisë së Infrastruktura dhe Energjise, (ose Ministrise kompetente të kohës) Republika e Shqipërisë. (Rregullorja për kriteret dhe procedurat e dhënies së licensave profesionale të individëve dhe subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit të

projektimit te ndertimit dhe mbikeqyrje e kolaudikimit te punimeve miratura me VKM- ne, Nr.759, date 12.11.2014 i ndryshyar. Mosparaqitja ne kete forme eshte kusht skualifikues.

b) Operatori duhet të ketë aktivitet mbi pese vjet i regjistruar dhe minimumi tre vjet në objektin e veprimtarisë së tij të ketë punime ose shërbime që kane lidhje me objektin e kontratës që prokurohet pra të ofrojë shërbime në fushën e gjeodezisë, hartografisë, topografisë, IT dhe kryesisht ne sistemet GIS, krijim arkivash dixhitale.

Kjo duhet të vërtetohet me:

- Profilin e kompanisë

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, Vendimin e Keshillit të Ministrave Nr. 759/2014 Per licencimin profesional te individeve dhe subjekteve juridikeqe do te ushtrojne veprimari ne fushen e studimit e te projektimit...” si dhe pika 4/a, neni 41 i VKM 285/2021. Kategoritë janë kërkuar bazuar në proceset e punës sipas fazave të përcaktuara në termat e referencës. Licencat janë të lidhura ngushtësisht me specifikimet e termave të referencës. Këto licenca janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës dhe operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret.

2.3.3 Operatori duhet të ketë të punësuar, prej një periudhe tre mujore nga data e zhvillimit e tenderit, minimumi 6 (gjashtë) specialiste me experiencë në fushat e nevojshme per realizimin e regjistrimit fillestar, te vertetuar me dokumentacionin perkates (CV, Diplome, Certificate, Liçensat kur kërkohen, Çertifikatat kur kërkohen), detajuar si më poshte:

a) Të pakten 1(nje) Projekt Menaxher me experience jo më pak se 5 vjeçare ne projekte te ngjashme. Projekt Menaxheri duhet te kete mbaruar studimet ne degët: Inxhinieri elektronike, Gjeodezi, Informatike ose degë të ngjashme.

b) Operatori duhet të ketë të punësuar jo më pak se 1 (një) specialist të liçensuar që zoteron Liçense aktive ne projektim te Kat. 8a – Rilevime inxhinierike, Kat. 8b – Rilevime Inxhinierike Kadastrale, Kat.8c – Sisteme GIS dhe 8d-Bazamente Gjeodezike si dhe sisteme GIS.

Specialisti duhet të ketë eksperiencë jo me pak se 5 vite në projekte për regjistrimin fillestar të pasurive të paluajtshme ne fushat për të cilat ai është i liçensuar dhe i çertifikuar. Specialisti duhet të ketë përfunduar arsimin e lartë ne degët: Gjeodezi, Gjeoinxhinieri ose degë të ngjashme. Po keshtu ai duhet të ketë njohuri në përdorimin e droneve profesional per qëllime hartografike (rilevime, ortofoto etj), e pajisjeve te GPS receiver dhe pajisjeve te tjera për rilevime kadastrale me saktësi të lartë.

c) Operatori duhet të ketë të punësuar jo me pak se 1 nje specialist Hartograf të Liçensuar që zoteron Liçense aktive ne projektim te Kat. 8a – Rilevime inxhinierike, Kat. 8b – Rilevime Inxhinierike Kadastrale, Kat.8c – Sisteme GIS, 8d-Bazamente Gjeodezike dhe Kat. 8e-Projektim fotogrametrik dhe hartografik si dhe me eksperiencë me jo më pak se 5 vite ne krijimin e hartave kadastrale me anë të sistemeve GIS, kryesisht në projekte për regjistrimin fillestar të paurive të paluajtshme. Specialisti duhet të kenë përfunduar arsimin e lartë në degët: Gjeodezi, Gjeoinxhinieri ose degë të ngjashme.

d) Operatori duhet të ketë të punësuar jo më pak se 1 (nje) Jurist me eksperiencë jo më pak se 5 vjet ne fushën e Regjistrimit Fillestar të Pasurive të Paluajtshme

e) Operatori duhet të ketë të punësuar jo më pak se 2 dy ekspert IT se 5 vjeçare ne projekte të ngjashme. Ekspertët duhet të kenë mbaruar universitetin ne degët Informatikë, Inxhinieri informatike, Elektronike ose degë të ngjashme.

Për secilin prej specialisteve Operatori/et Ekonomike duhet te paraqesin:

- kualifikimet arsimore (diplomat),
- CV
- Licencat ku kerkohen
- Certifikata kur kerkohen

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ b), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Ky kriter vërteton eksperiencën në fushën objekt prokurimi me qëllim realizimin e objektit të prokurimit. Përvoja e operatorit është element shumë i nevojshëm për autoritetin, për të vërtetuar qëndrueshmërinë ekonomike të ofertuesit, eksperiencat dhe besueshmërinë në përmbushjen e sukseshme të kontratës. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, vlerësohet në lidhje me personelin teknik të nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës. Stafi teknik duhet të angazhohet. Çdo staf teknik do të jete përgjegjës për kryerjen e detyrave të përcaktuara për çdo fazë të regjistrimit.

Për përpunimin e të dhëave gjeohapsinore dhe sidomos punët fotogrametrike, nevojitet 2 inxhinierë të specializuar mbi përdorimin e Dronëve dhe përpunimin e materialeve (fotografike) të përfuturara nga fluturimet. Një inxhinier nevojitet për fotografimet në terren dhe një inxhinier për përdorimin e softwareve specifik për përpunim fotogrametrik.

Inxhinierët e kërkuar janë përgjegjës për grumbullimin e të dhënave në terren dhe përpunimin e informacioneve dhe dixhitalizimin e tyre. Për përmbushjen në kohë të afatëve të kontratës nevojiten së paku 2 grupe pune në terren ku secili grup të ketë një topograf, inxhinier gjeodet, gjeoinxhinier etj. të përcaktuar në këtë pikë, si dhe inxhinier në IT për të përpunuar materialet në kohë reale. Juristët janë përgjegjës për implementimin e njohurive juridike mbi çështjet e pronësisë dhe ligjet në fuqi për pronat.

2.3.4 Operatori Ekonomik duhet të ketë jo më pak se 15 pesëmbëdhjetë punonjës të siguruar për çdo muaj prej periudhës tre mujore nga data e zhvillimit të tenderit. Si dëshmi për fuqinë punëtore do të dorëzohen dokumentet si më poshtë;

- Vërtetimi të lëshuar nga administrata tatimore për një periudhë tre mujore nga data e zhvillimit të tenderit shoqëruar me listëpagesat sipas formatit që kërkohet nga legjislacionin tatimor.

-Për dokumentet që nuk lëshohen në vendin e origjinës, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë këtë fakt, përndryshe dokumentacioni do të konsiderohet i paparaqitur

Argumentimi 2.3.4: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/c, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë punëtore të të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën. Numri i përcaktuar i punonjësve është përlllogaritur duke u bazuar në shërbimet e kërkuara sipas Termave të referencës, volumet dhe fazat e regjistrimeve, kualifikimi i punonjësve, grafiku i punimeve (sipas grafikut të miratuar nga Drejtoria e Përgjithshme e ASHK), zërat e punimeve dhe orët e punës sipas Kodit të Punës etj.

2.3 5. Operatori duhet zoteroje (ne pronesi ose me qera) minimalisht:

- a) Skanera duplex për skanimin e dokumenteve të pasurive të paluajtshme. Skanerat duhet të skanojnë me ngjyra dokumente të formatit A4 e A3.
- b) Set GPS Gjeodezik Baze-Rover
- c) Total Station, me karakteristika minimale: saktësisë së lartë 1". Matje pa prizem deri 1000m, Saktësia me prizem 1+1ppm, minimum lexim kendi 0.1".
- d). Dron per hartëzim, i cili duhet të ketë karakteristikat minimale: saktësia centimetrike
- e) Skaner Lidar dhe Kamer RGB, me karakteristika minimale, saktësi centimetrike (metode pozicionimi PPK).

-Operatori duhet vërtetohet që ai ka në pronësi ose qera pajisjet hardware (pikat a-e). Në rastin e pronësisë ai duhet të paraqesë dokumentet vërtetuese si fatura dhe/ose vërtetimi doganor dhe në rastin që ato do të merren me qera duhet të paraqitet kontrata për marrjen me qera të këtyre pajisjeve si dhe dokumentet e pronësisë mbi keto pajisje të qeradhenesit.

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë disponimin e mjeteve dhe pajisjeve në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës nr. 10. Formulari i vetëdeklarimit duhet të përmbajë kërkesat e autoritetit. Autoriteti/enti kontraktor.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021“Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion mjetet për të përmbushur kontratën. Numri dhe lloji i mjetit janë vlerësuar të nevojshme, duke ju referuar natyrës dhe permasat e kontrates, vendeve ku do të realizohen regjistrimet me një shtrije të gjere gjeografike ne disa njesi vendore (bashki), si dhe kohezgjatjes se sherbimit. Duke qene se ne terren do jene se paku dy grupe, per secilin grup nevojitet nje GPS dhe nje Total Station per kryerjen e matjeve te sakta. Po ashtu per secilin grup, ne menyre qe matjet dhe materialet te grumbullohen e te perpunohen brenda afateve, nevojitet nga nje Dron professional .Pas perpunimit te fotove, mund te gjenerohen ortofoto te gjithe zones,e cila ndihmon ne perpunimin dhe perpilimin e hartave ne zyre. Duke qene se fluturimet do te kryhen ne lartesi mbi 100m ( per shkak te siperfaqes se madhe) , nevojitet kamera profesionale me rezolucion jo me pak se 36 mpx, ne menyre qe ne ortofoto te dallohen detaje te ndryshme si gardh, kufinj prone, apo lumenje te cilet mund te jene te paarrtshem ne rruge tokesore gjate matjeve.(Produkti i LIDAR)

2.3.6 Operatori Ekonomik duhet të disponojë dhe paraqesë certifikata të vlefshme::

- Çertifikatë ISO 9001/2015 për Sistemin e Menaxhimit të Cilësisë ose ekuivalent të cilat duhet të jenë të vlefshme në periudhën kur zhvillohet tenderi, e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.
- Çertifikate ISO 27001 e Sistemit Menaxhial të Sigurisë së Informacionit ose ekuivalente të cilat duhet të jenë të vlefshme në periudhën kur zhvillohet tenderi, e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.
- Çertifikate ISO/IEC 20000 e Sistemit Menaxhial të Shërbimeve në fushën e Teknologjisë së Informacionit ose ekuivalente të cilat duhet të jenë të vlefshme në periudhën kur zhvillohet tenderi, e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Pranohet dhe paraqitja e standardeve shqiptare SSH mbi konformitetin e standardeve europiane dhe të lëshuara nga organizma të vlerësimit të konformitetit të akredituara në Republikën e Shqipërisë.

*Argumentimi:* Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 79, “Standardet e sigurimit të cilësisë dhe standardet e menaxhimit mjedisor” të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, dhe nenin 39, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Për vet natyrën e veçantë, vendndodhjes dhe përmasat e objektit të kontratës që do të prokurohet, është tepër e rëndësishme që operatorët si zbatues, të kryejnë veprimtarinë me standardet e kërkuara të cilësisë. Sistemi i menaxhimit të të sigurisë së informacionit janë standarde që çdo operator e ka qëllim në arritjen e suksesit. Këto certifikata lidhen ngushtësisht me objektin e kontratës përsa kohë do të pronohen edhe ekuivalentet e tyre dhe i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e kapaciteteve të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen e plotë të kontratës me cilësi dhe sigurimin e informacionit. Referuar në nenin 79 të ligjit 162/2020, parashikohet se autoriteti kontraktor mund të kërkojë certifikata, të lëshuara nga organe të pavarura, që vërtetojnë pajtueshmërinë e kandidatit ose të ofertuesit me standardet e kërkuara të cilësisë, përfshirë sigurinë e informacionit në format copy dhe elektronik në sistem.

*(Shënim- argumentoni nevojën për stafin e kërkuar, duke specifikuar shërbimet apo veprimtaritë konkrete për të cilat kërkohet ekspertiza e tyre profesionale, argumentimin mbi kërkesat dokumentare për disponimin e këtij stafi, si dhe nëse është rasti, për llojin e licencës/certifikatës/kualifikimit të kërkuar për secilin prej tyre, duke specifikuar edhe aktin ligjor apo nënligjor konkret, ku parashikohet nevoja për licencimin apo certifikimin e tyre).*

*Shënim: Autoretiti /enti kontraktor mund të kërkojë edhe:*

**Arsvreja pse nuk është ndare në lote:** Autoriteti ka vendosur të zhvillojë procedurën pa lote pasi natyra e kontratës nuk është e perzier, por vetëm kryerjen e procesit të regjistrimit fillestar në zonat kadastrale të të përcaktuara në termat e referencës me potencial turistik, për të cilën ka përzgjedhur si mjet prokurimi Marrveshjen Kuader me një operator.

## II. Argumentimi i specifikimeve teknike

*Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për shërbimet objekt prokurimi, që do të përfshihen në termat e referencës, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 41, pika 1, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.*

*Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.*

*Termet e referencës janë pjesë e DST*